



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. _____prot.

Tiranë, më 10.3.2021

Lënda: Parashtrimet e Komisionerit Publik në seancën gjyqësore pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, datë 10.3.2021, për çështjen ankim kundër vendimit nr. 161, datë 18.6.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit z. Kastriot Selita

Baza ligjore: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”

Drejtuar: Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

Të nderuar anëtarë të trupit gjykues,

Në zbatim të nenit 55, pika 7 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë (IKP), më datë 24.7.2019, është njoftuar vendimi nr. 161, datë 18.6.2019, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit z. Kastriot Selita, gjyqtar/Kryetar i Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, me anë të vendimit nr. 161, datë 18.6.2019, me shumicë votash, ka konfirmuar në detyrë subjektin e rivlerësimit, z. Kastriot Selita.

Ndaj këtij vendimi, bazuar në nenin B, pika 3, germa “c¹” e aneksit të Kushtetutës dhe nenin 65, pika 2² e ligjit nr. 84/2016, një komisionin prej tre vëzhguesish të Operacionit Ndërkombëtar i Monitorimit (në vijim referuar ONM), kanë paraqitur pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë aktin “Rekomandim për paraqitje ankimi”.

Komisioneri Publik, pas verifikimit të situatës faktike, analizës dhe vlerësimit të provave dhe akteve të dala nga hetimi administrativ i Komisionit, në zbatim edhe të rekomandimit të ONM-

¹ Vëzhguesi ndërkombëtar ushtron këto detyra ... u jep Komisionerëve Publikë rekomandime me shkrim për të paraqitur ankim. Në rast se Komisioneri Publik nuk i zbaton rekomandimet, ai përgatit një raport me shkrim, duke dhënë arsyet e refuzimit.

² Vëzhguesi ndërkombëtar ka të drejtë të paraqesë rekomandim me shkrim Komisionerit Publik për të paraqitur ankim. Ky rekomandim jepet nga një komision i përbërë nga të paktën 3 përfaqësues të ONM-së.

së, çmon se procesi i hetimit administrativ të kryer nga Komisioni nuk ka qenë i plotë, për rrjedhojë, përfundimet e arritura për konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit nuk janë në pajtueshmëri me provat e administruara, referuar kërkesave të nenit 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, sikundër edhe nga një vlerësim i përgjithshëm të tria kritereve, referuar nenit 4, pika 2, të këtij ligji.

Komisioneri Publik, duke i qëndruar të gjitha shkaqeve të parashtruara në ankimin e tij, çmon se vendimi nr. 161/2019 është i cenueshëm në tërësinë e tij, si dhe përmban shkaqe të mjaftueshme ligjore për t'iu nënshtruar juridiksionit rivlerësues dhe kontrollues nga Kolegji i Posaçëm i Apelit, e për këto arsye, bazuar në nenin C, pika 2, nenin F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës dhe nenin 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, i kërkojmë Kolegjit vlerësimin e çështjeve si më poshtë:

I. Për kriterin e pasurisë

1. Për pasurinë “*Apartament me sip. 124,9 m²*”, me adresë rruga “****.***”, pallati “****”, Tiranë, vlerësohet e nevojshme riçelja e hetimit administrativ në funksion të kryerjes së një analize mbi ligjshmërinë e origjinës së burimit të krijimit të shumës 110.000 euro, si një nga burimet e deklaruara për blerjen e kësaj pasurie. Më konkretisht, për çështjet që lidhen me: (i) periudhën e kryerjes së pagesave për pasurinë në pronësi të familjes së personit të lidhur, bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, shtëpi banimi 2 kate + papafingo me sip. 268.2 m²; (ii) koston e ndërtimit të objektit shtëpi banimi 2 kate + papafingo...; (iii) ligjshmërinë e të ardhurave të personit të lidhur, bashkëshortes së subjektit, deklaruar nga fondacioni “****.***.***” Albania; (iv) shpenzimet e qirasë dhe mobilimit të familjes ***; si dhe (v) metodologjinë e llogaritjes së shpenzimeve të jetesës.

2. Për pasuritë “*Apartament me sip. 29,86 m²*” dhe “*Garazh me sipërfaqe 12,5 m²*”, me adresë rruga “****.***”, pallati “****”, Tiranë, vlerësohet e nevojshme riçelja e hetimit administrativ dhe kontrollit për çështjet që lidhen me: (i) destinacionin e kredisë së marrë nga personi i lidhur, bashkëshortja e subjektit, nga *** Bank; (ii) ligjshmërinë e shumës 20.000 euro, përdorur për shlyerjen e kredisë pranë *** Bank; (iii) mundësinë financiare të personit të lidhur, bashkëshortes së subjektit, për të kursyer shumën 9.000 euro; (iv) pagimin e detyrimeve tatimore për fitimin e realizuar nga shitja e apartamentit me sip. 102 m².

3. Për pasurinë “*Apartament me sip. 205,33 m² dhe truall me sip. 521.8 m²*”, me adresë “fshati - ***”, Durrës, vlerësohet e nevojshme riçelja e hetimit për çështje që lidhen me: (i) ligjshmërinë e shumës 30.000 euro, dhënë *cash* personit të lidhur, bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit nga familja e saj; (ii) ligjshmërinë së shumës 2.900.000 lekë, përfituar nga subjekti i rivlerësimit, nga ish-bashkëshortja, në vitin 2006, si origjinë e burimit të deklaruar në shumën 35.000 euro.

4. Për pasurinë autoveturë “Daimler Chrysler”, hetimi do të duhet të shtrihet në verifikimin e ligjshmërisë së burimit të krijimit të kësaj pasurie.

II. Për kriterin e aftësive profesionale

5. Komisioneri Publik, bazuar edhe në rekomandimin e ONM-së, vlerëson se përfundimet e arritur nga Komisioni për këtë kriter duket se nuk janë në pajtueshmëri me situatën faktike të konstatuar. Vlerësohet e nevojshme rishikimi dhe hetimi administrativ në funksion të rivlerësimit të këtij kriteri nga juridiksioni kontrollues i Kolegjit, pasi nga hetimi administrativ i Komisionit ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e anëtarit të trupit gjykues ose të relatorit të çështjes, ka vepruar në situatën e konfliktit të interesit apo të atij në dukje. Referuar kërkesave të nenit 53, të ligjit nr. 84/2016, rezulton se Komisioni nuk ka dhënë përgjigje për të gjithë sa pretendohet në denoncimet e paraqitura. Gjithashtu, nga vlerësimi tërësor i çështjes, Komisioni nuk ka marrë në konsideratë, nëse për faktet e konstatuara gjen zbatim neni 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

III. Analiza e shkaqeve të ankimit

III. A.1 Kontrolli i pasurisë

6. Për sa parashtruam shkaqet si më sipër, në mënyrë të përmbledhur, për efekt të këtij gjykimi, Komisioneri Publik çmon si të nevojshëm një hetim dhe vlerësim të mëtejshëm lidhur me pasuritë në pronësi të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur me të, bashkëshortes, duke analizuar:

7. Për pasurinë “Apartament” me sipërfaqe 124,91 m², me nr. pasurie *, z. k. ***, me adresë rr. “***.***”, pallati “***”, Tiranë**

7.1 Në D-Vett. dhe DV-2015, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “Apartament” me sipërfaqe 124.91 m², fituar me kontratë shitje pasurie të paluajtshme nr. *** rep. dhe nr. *** kol., datë ***.12.2015. Vlera: 177.370 euro dhe shpenzime mobilimi në vlerën 21.354 euro. Pjesa takuese: 50 % në bashkëpronësi me bashkëshorten. **Burimi i krijimit:** (i) kredi bankare nga ***, në shumën 85.000 euro; (ii) kursime nga të ardhurat familjare të vitit 2015, në shumën 3.724 euro; (iii) të ardhurat nga shitja e apartamentit³ me sipërfaqe 94,6 m², në adresën rruga “***.***”, pallatet “***”, Tiranë, në shumën 110.000 euro.

7.2 Komisioni, në përfundim të hetimit administrativ, për pasurinë apartament banimi, me sip. 124,91 m², ka konkluduar se: “Subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të saktë sipas nenit 30 dhe pikës 5 “a”, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, ka justifikuar dhe shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj pasurie në kuptim të nenit D të aneksit të Kushtetutës⁴.”

7.3 Komisioneri Publik vlerëson të ndalet në trajtimin e burimit të deklaruar: “**të ardhurat në shumën 110.000 euro nga shitja e apartamentit me sip. 94.6 m²**, në rruga “***.***”, pallatet “***”, që ka si origjinë fillestare gjendjen pasurore dhe financiare të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit dhe familjes së saj, në momentin e krijimit të pasurisë: Shtëpi banimi 2 kate + papafingo me sip. totale ndërtimi 268.2 m² dhe truall me sip. 330 m², ndodhur në Linzë, Tiranë, shitja e së cilës, më pas ka shërbyer si burim krijimi për apartamentin me sip. 94.6 m².”

³ Apartamenti ka qenë në pronësi 100% të bashkëshortes së subjektit, znj. ***.***.

⁴ Referohuni f. 19, të vendimit të Komisionit.

7.4 Komisioni⁵ e ka kualifikuar bashkëshorten e subjektit të rivlerësimit: “person të lidhur me të” dhe prindërit e saj: “persona të tjerë të lidhur”, duke analizuar mundësinë financiare për krijimin e pasurisë: Shtëpi banimi 2 kate + papafingo, me sip. totale ndërtimi 268.2 m,² në Linzë, Tiranë, dhe, në përfundim, në analizë të ligjshmërisë së burimit të krijimit të kësaj pasurie, ndër të tjera, ka vlerësuar: “... se personi i lidhur dhe familja e saj kanë pasur burime të ligjshme për blerjen e tokës dhe për ndërtimin e shtëpisë⁶”.

8. Komisioneri Publik, në zbatim dhe të rekomandimit të ONM-së⁷, lidhur me burimin e ligjshëm të krijimit të pasurisë “Shtëpi banimi 2 kate + papafingo, me sip. 268,2 m²”, shitja e së cilës është burimi i krijimit të pasurisë “Apartament banimi, me sip. 124,91 m,²” në pronësi të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes së tij, e çmon të nevojshme riçeljen e hetimit dhe vlerësimin nga ana e Kolegjit të çështjeve si vijon:

8.1 *Lidhur me periudhën e kryerjes së pagesave për pasurinë: Shtëpi banimi 2 kate + papafingo me sip. 268.2 m²*

8.1.1 Në dosjen e Komisionit, ndër të tjera, është administruar shkresa nr. *** prot., datë ***.12.2018, e shoqërisë “****” sh.p.k.,⁸ sipas së cilës pagesa e situacioneve për ndërtimin e objektit: Shtëpi banimi 2 kate + papafingo, me sip. 268.2 m², është kryer në vitet 2003-2004. Në këtë shkresë, specifikohet se nga shuma 4.754.112 lekë, është paguar deri në datën ***.12.2003, shuma 4.377.090, dhe pjesa e mbetur, prej 377.022 lekë, është paguar në datën ***.7.2004. Ndërsa në analizën e kryer nga Komisioni për vlerësimin e burimit të ligjshëm të krijimit të kësaj pasurie rezulton të jenë përfshirë edhe të ardhurat e familjes ***, të realizuar pas muajit korrik 2004⁹.

8.1.2 Në vlerësimin e Komisionerit Publik mbetet i paqartë shkaku pse në analizën financiare të kryer nga Komisioni janë përfshirë të ardhurat e realizuara nga familja *** pas korrikut të vitit 2004, pavarësisht se shkresa e shoqërisë “****” sh.p.k ka përcaktuar si datë të pagesës së fundit, datën ***.7.2004.

8.2 *Lidhur me koston e ndërtimit të objektit: Shtëpi banimi 2 kate + papafingo me sip. 268,2 m²*

8.2.1 Nga shqyrtimi i akteve në dosje për këtë objekt, referohen tri vlera të ndryshme të kostos së ndërtimit. Konkretisht: (i) Në deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës, personi i lidhur, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, znj. ***.***, ka deklaruar vlerën e objektit në shumën 5.000.000 lekë¹⁰; (ii) Komisioni në vendimin e tij (f. 12), ka arsyetuar

⁵ Referohuni f. 10, të vendimit të Komisionit.

⁶ Referohuni f. 17, të vendimit të Komisionit.

⁷ Referohuni pikës 4/1, germa “f” dhe “h” të rekomandimit të ONM-së.

⁸ Depozituar gjatë kryerjes së procesit të rivlerësimit dhe bashkëlidhur saj faturat tatimore të lëshuara nga shoqëria.

⁹ Referohuni analizës financiare të kryer nga Komisioni, paraqitur në tabelën nr. 5, f. 15, të vendimit. Në këtë tabelë citohet periudha 1997-2004, në zërin: “të ardhura nga pagat ***.*** dhe ***.***” citohet periudha 1997-2005, ndërsa nga aktet duket se janë llogaritur të ardhurat e realizuara deri në dhjetor 2004.

¹⁰ Në përgjigjet e datës 14.11.2018, subjekti ka deklaruar se vlera e ndërtimit është 4.754.112 lekë. Kjo shumë i është paguar *cash* shoqërisë sipërmarrëse gjatë periudhës 2003 - 2004. Shuma e deklaruar në DV- 2005 nga bashkëshortja, në shumën 5 milionë lekë, përbëhet nga shuma 4.754.112 lekë (vlera e ndërtimit sipas vlerës së projektit), si dhe shuma 245.888 lekë, që ka të bëjë me pagesat e ndryshme, të cilat janë bërë për projektim (arkitekturor, inxhinierik, elektrik, hidraulik) etj.

se kostoja e ndërtimit ka qenë 24.446 lekë/m² x 268.2 m² me vlerë totale 6.556.417,2 lekë¹¹, por pavarësisht këtij konstatimi në analizën financiare ka reflektuar vlerën e kostos së ndërtimit për këtë pasuri në shumën 4.754.112 lekë; (iii) Subjekti i rivlerësimit, në përgjigjet e pyetësorit nr. 2, datë 15.8.2018, ka paraqitur dokumentacion mbështetës për pagesat tatimore mbi të ardhurat e përfituara nga shitja e asetit në vlerën 220.000 euro. Sipas mandatit të *** Bank, datë ***.7.2008, z. ***.***, ka paguar shumën 1.902.280 lekë, me përshkrim: *“pagesë takse për shitblerje shtëpie 10% të fitimit kapital për ZRPP Tiranë”*. Bashkëlidhur këtij veprimi arke është edhe një fletë përlllogaritjeje e kësaj takse nga ana e ZVRPP-së Tiranë, format i thjeshtë A4, nga e cila rezulton se kostoja e ndërtimit të shtëpisë, si çmim reference, është vlerësuar 27.000 lekë/m² x 268.2 m², me vlerë prej 7.241.400 lekë, që së bashku me vlerën e truallit prej 600.000 lekësh, sipas kontratës përkatëse të shitblerjes, shkojnë në total në shumën 7.841.400 lekë.

8.2.2 Sa më sipër analizuar, referuar dhe rekomandimit të ONM-së¹², në vlerësimin e Komisionerit Publik mbetet e paqartë pse në analizën financiare të kryer nga Komisioni është reflektuar si kosto ndërtimi vlera 4.754.112 lekë, kur nga aktet e administruara në dosje reflektohen vlera më të larta.

8.3 *Lidhur me ligjshmërinë e të ardhurave nga fondacioni “***.***.***” Albania*

8.3.1 Nga shqyrtimi i analizës financiare të Komisionit, konstatojmë se në zërin: *“pagat të znj. ***.***, për periudhën 1999-2004”*, në shumën 2.954.608 lekë¹³, është përfshirë dhe shuma 1.630.035 lekë, me burim të ardhurat nga fondacioni “***.***.***” Albania.

8.3.2 Gjatë hetimit administrativ nga ana e Komisionit është administruar shkresa e ISSH-së me nr. *** prot., datë ***.11.2018, e cila sqaron se për periudhën korrik 2000 deri në shkurt 2004, nuk figuron në listëpagesat e subjektit juridik “***.***.***” Albania, emri i shtetasës ***.***. Ndërsa DRT Tiranë, me shkresën nr. *** prot., datë ***.11.2018, ka informuar Komisionin se: *“... subjekti ‘***.***.***’ Albania ka kryer pagesa tatimi në burim për shërbime konsulence, për periudhën 2002-2004. Lidhur me këto pagesa tatimi në burim, nuk janë të specifikuar në përshkrim apo të deklaruara nga shoqëria se kujt individit i takon pagesa e tatimit në burim”*.

8.3.3 Subjekti i rivlerësimit, gjatë hetimit administrativ,¹⁴ për të provuar marrëdhënien e shërbimit me fondacionin “***.***.***” Abania, ka paraqitur një kontratë shërbimi “Service Agreement” për periudhën ***.1.2004 - ***.12.2004. Në nenin 4 të kësaj kontrate, parashikohet se: *“znj. ***.***, në cilësinë e ofruesit të shërbimit, duhet të paguajë të gjitha detyrimet tatimore që rrjedhin nga kjo marrëdhënie”*.

8.3.4 Sa më sipër, Komisioneri Publik vlerëson se, nga gjendja e akteve në dosje, nuk rezulton të jetë paraqitur dokument justifikues për të vërtetuar ofrimin e shërbimit nga znj. ***.***,

¹¹ Bazuar në udhëzimin nr. 1, datë 4.3.2004, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, i vlerave të tregut të lirë të banesave dhe koeficientit ‘K’”.

¹² Referohuni pikës 4/1, germa “F”, të rekomandimit të ONM-së.

¹³ Referohuni analizës financiare në tabelën nr. 5, në f. 15, të vendimit të Komisionit.

¹⁴ Referohuni akteve bashkangjitur përgjigjeve, të datës 14.8.2018, në dosje të Komisionit.

pranë fondacionit “***.***.***” Albania, për periudhën përkatëse, duke mbetur ky pretendim një fakt i paprovuar dhe në nivel deklarativ. Si rezultat, bazuar edhe në rekomandimin e ONM-së, vlerësojmë se nuk është përmbushur detyrimi kushtetues dhe ligjor i hetimit të justifikimit të ligjshmërisë së burimit të krijimit të të ardhurave të ligjshme në shumën 1.630.035 lekë, referuar pikës 3, të nenit D të aneksit të Kushtetutës.

8.4 *Lidhur me shpenzime qiraje dhe mobilimi të familjes ****

8.4.1 Rezulton se Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, me shkresën nr. *** prot., datë ***.1.2018, konfirmon se familja ***, më datë ***.3.1996, ka ndryshuar vendbanimin nga Bashkia Peshkopi në Njësinë Bashkiake nr. ***, Tiranë. Nga arsyetimi i vendimit të Komisionit, nuk na rezulton që të jetë hetuar lidhur me shpenzime të mundshme qiraje të familjes ***, për një periudhë 8-vjeçare, kohë kur ka përfunduar ndërtimi i shtëpisë së banimit (268,2 m²) në Linzë, Tiranë, në pronësi të tyre. Gjithashtu, nga hetimi administrativ i Komisionit, rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk është pyetur lidhur me shpenzimet e kryera për mobilimin e shtëpisë së banimit me sip. 268,2 m² në Linzë, ku familja *** ka jetuar në periudhën 2004-2008.

8.4.2 Komisioneri Publik, për sa më sipër, çmon si të nevojshme të hetohet në drejtim të: (i) shpenzimeve të mundshme të qirasë; dhe (ii) shpenzimeve të mobilimit të kryera nga familja ***, rrethana të cilat do të ndikojnë në analizën financiare për kontrollin e ligjshmërisë së të ardhurave për krijimin e pasurisë: Shtëpi banimi 2 kate + papafingo me sip. 268,2 m².

8.5 *Lidhur me metodologjinë e llogaritjes së shpenzimeve të jetesës*

8.5.1 Komisioneri Publik vlerëson se në analizën financiare të kryer nga Komisioni, për burimin e ligjshëm të krijimit të pasurisë shtëpi banimi (268,2 m²) dhe truall (330 m²), ka ndikim edhe metodologjia e llogaritjes të shpenzimeve të jetesës të familjes ***. Në vendimin e Komisionit¹⁵ konstatohet se shpenzimet e jetesës për familjen *** janë llogaritur në shumën 1.440.000 lekë për periudhën 1997-2002 dhe 1.285.714 lekë për periudhën 2003-2004.

8.5.2 Nisur nga sa më sipër, nuk rezulton e qartë metodologjia e përdorur nga Komisioni për llogaritjen e shpenzimeve të jetesës së familjes ***, për periudhën para dhe pas vitit 2003. Në këto rrethana, do të ishte i nevojshëm interpretimi/orientimi i Kolegjit mbi metodologjinë që do të duhet të përdoret për llogaritjen e shpenzimeve të jetesës për periudhën përpara vitit 2003 dhe pas këtij viti.

8.6 Në përfundim, Komisioneri Publik, për sa më sipër analizuar, çmon si të nevojshme një hetim shterues lidhur me shpenzimet e mundshme të qirasë dhe të mobilimit të familjes ***, si dhe kryerjen e një analize financiare nga ana e Kolegjit, me qëllim vlerësimin e ligjshmërisë së burimit të krijimit të pasurisë shtëpi banimi 2 kt., + papafingo me sip. 268.2 m², shitja e së cilës deklarohet si origjina e shumës 110.000 euro, që është një nga zërat për krijimin e pasurisë ap.

¹⁵ Referohuni analizës financiare në f. 16, të vendimit të Komisionit.

banimi me sip. 124.91 m², në pronësi të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur me të, bashkëshortes.

9. Pasuria “Apartament” me sipërfaqe 29,86 m², me nr. pasurie *, z. k. ***, rr. “***.***”, pallati “***”, Tiranë**

9.1 Në *D-Vett. dhe DV-2016*, subjekti ka deklaruar: Apartament me sipërfaqe 29,86 m², fituar me kontratë shitje nr. *** rep., nr. *** kol., datë ***.12.2016, me vlerë 46.000 euro. Pjesa takuese 50 % në bashkëpronësi me bashkëshorten.

10. Pasuria “Garazh” me sipërfaqe 12.5 m², me nr. pasurie *, z. k. ***, rr. “***.***”, pallati “***”, Tiranë**

10.1 Në *D-Vett. dhe DV-2016*, subjekti ka deklaruar: “Garazh” me sipërfaqe 12.5 m², fituar me kontratë shitje pasurie të paluajtshme nr. *** rep., nr. *** kol., datë ***.12.2016, me vlerë 24.000 euro. Pjesa takuese 50% në bashkëpronësi me bashkëshorten.

11. Si burim krijimi për dy pasuritë më sipër, në vlerë totale 70.000 euro, janë deklaruar të ardhurat e përfituara nga shitja e apartamentit me sip. 115.08 m², në adresën rruga “***.***”, pallatet “***”, Tiranë, në pronësi të bashkëshortes së subjektit znj. ***.***, në shumën 130.000 euro.

12. Për blerjen e apartamentit me sip. 115.08 m² deklarohen si burim të ardhurat e bashkëshortes të përfituara nga shitja e apartamentit me sipërfaqe 102 m², me adresën rruga e “***”, Linzë, Tiranë, në shumën 50.000 euro. Në cilësinë e personit të lidhur, por dhe si subjekt deklarues, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, deklaroi se blerja e apartamentit me sipërfaqe 102 m² ka si burim krijimi: **(i)** kredi bankare pranë *** Bank, në shumën 23.000 euro; **(ii)** 9.000 euro, nga kursimet familjare, për periudhën 2001-2005.

13. Nga sa më sipër deklaruar, rezulton se shuma 70.000 euro, që ka shërbyer për blerjen e pasurive ap. me sip. 29,86 m² dhe garazh me sip. 12.5 m², aktualisht në bashkëpronësi të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur me të, ka si origjinë fillestare shumën e përfitur nga shitja e ap. me sip. 102 m², në rr. e “***”, Linzë, Tiranë.

14. Komisioneri Publik, në zbatim dhe të rekomandimit të ONM-së¹⁶, e çmon të nevojshme riçeljen e hetimit dhe vlerësimin nga ana e Kolegjit të këtyre çështjeve si vijon:

15. *Lidhur me kredinë bankare të marrë nga *** Bank, në shumën 23.000 euro*

15.1 Nga aktet në dosje të Komisionit¹⁷, rezulton se znj. ***.*** ka marrë kredi pranë *** Bank, në shumën 23.000 euro, me kontratë kredie nr. *** rep., nr. *** kol., datë ***.11.2004. Pjesë e dokumentacionit të dosjes së kredisë është dhe deklarata noteriale me nr. *** rep., nr. *** kol., datë ***.9.2004, nënshkruar nga z. ***.*** dhe personi i lidhur, bashkëshortja znj. ***.***. Referuar përmbajtjes së deklaratës, rezulton se znj. ***.*** ka marrë hua shumën 23.000 euro nga

¹⁶ Referohuni pikës 4/1, germës “a” dhe “c”, të rekomandimit.

¹⁷ Referohuni informacionit të përcjellë nga *** Bank, me shkresën nr. ***, datë ***.1.2018.

shtetasi ***.***¹⁸. Qëllimi i dhënies së huas, në maj 2004, në shumën 23.000 euro (pa interes), është për *“ndërtimin e një shtëpie”*, në Linzë, Tiranë.

15.2 Nga verifikimi i lëvizjeve të llogarisë bankare ka rezultuar se, pas disbursimit të kredisë bankare, shuma 22.615 euro është transferuar në datën ***.11.2004, në llogarinë e z. ***.***, me përshkrimin: *“transfer to the account of the lender”*¹⁹.

15.3 Komisionit, në përfundim të hetimit administrativ, ndër të tjera, i ka rezultuar se kredia nga *** Bank është përdorur për shlyerjen e huas së marrë nga z. ***.***, ndryshe nga sa është deklaruar në deklaratën “Vetting” dhe deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës (deklarim i bashkëshortes), se kjo kredi bankare është përdorur për blerjen e apartamentit prej 102 m² te shoqëria “***” sh.p.k., fakt për të cilin Komisioni i ka kaluar subjektit barrën e provës, bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016.

15.4 Subjekti i rivlerësimit, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, në parashtrimet e datës 16.4.2019, ka deklaruar se: *“...të gjitha veprimet e bëra me z. ***.*** kanë ndodhur brenda të njëjtit vit kalendarik. Banka *** ka miratuar kredinë në shumën 23.000 euro ... dhe datën ***.11.2004 është bërë shlyerja e borxhit ndaj z. ***.***. Në pamundësi të ndërtimit të shtëpisë, për shkak se nuk është marrë leja e ndërtimit, shuma e mbetur në dispozicion, prej 23.000 euro, është përdorur për të porositur apartamentin me sipërfaqe 102 m,² sipas kontratës së sipërmarrjes nr. *** rep., datë ***.7.2005, me adresë: Linzë, Tiranë. Veprimet e ndodhura gjatë vitit 2004 me z. ***.*** ishin veprime të ndërmjetme, zëvendësim debitori brenda të njëjtit vit kalendarik, pra në thelb destinacioni i kredisë së marrë u bë blerja e apartamentit nga shoqëria “***” sh.p.k.”.*

15.5 Komisioni, për sa më sipër, ndër të tjera, ka konkluduar:²⁰ *“...Lidhur me destinacionin e shpenzimit të kredisë prej 23.000 euro, për huan e marrë në vitin 2004, shpjegimi i subjektit ka të bëjë me veprime të ndërmjetme-zëvendësim debitori brenda të njëjtit vit kalendarik, nuk është bindës jemi përpara një pasaktësie në deklarim të personit të lidhur dhe, për rrjedhojë, edhe të subjektit të rivlerësimit, por që nuk e cenon ligjshmërinë e burimit të të ardhurave”.*

15.6 Komisioneri Publik, në analizë të akteve të administruara, shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit dhe përfundimit të arritur nga Komisioni, konstaton se duket sikur mungon nevoja financiare e këtyre transaksioneve. Ky konstatim vjen nga fakti se, ndërkohë që pretendohet se bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit i kishte të papërdorura fondet që mori hua pa interes nga z. ***.***, në maj të vitit 2004 (për shkak se sipas shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit nuk u bë e mundur marrja e lejes së ndërtimit), në nëntor të vitit 2004, znj. ***.*** merr një kredi bankare (me interes) në shumën 23.000 euro, për të shlyer huan e marrë (pa interes), fondet e së cilës i kishte gjendje të papërdorura.

¹⁸ Nuk rezulton që Komisioni të ketë kualifikuar z. ***.***, si person tjetër i lidhur, referuar pikës 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016.

¹⁹ Në rubrikën kushte speciale të disbursimit specifikohet: *“Transfer of the funds at the account of Mr. ***.*** (the lender)”*.

²⁰ Referohuni arsyetimit të Komisionit në f. 24, të vendimit.

16. Lidhur me shlyerjen e kredisë bankare pranë *** Bank

16.1 Për sa i takon shlyerjes së kredisë së marrë nga znj. ***, ne shumën 23.000 euro, pranë *** Bank, nga aktet në dosje rezulton se kredia është shlyer plotësisht në datën ***.5.2008, nëpërmjet një depozitimi *cash* në llogarinë e saj bankare, në shumën 20.042 euro.

16.2 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigjet e datës 14.8.2018, ka deklaruar se shuma 20.000 euro²¹ është përfituar nga shitja e pasurisë shtëpi banimi (me sip. 268,2 m²), ndodhur në Linzë, Tiranë.

16.3 Komisioneri Publik, në zbatim dhe të rekomandimit të ONM-së²², për shumën 20.000 euro, deklaruar si e përfituar nga shitja e pasurisë në pronësi të prindërve të bashkëshortes së tij, përveç sa më sipër trajtuar, lidhur me mundësinë financiare të familjes *** për krijimin e kësaj pasurie, vlerëson se mbetet e paqartë nëse kjo shumë do të kualifikohet si dhurim dhe nëse kualifikohet si e tillë, a duhet t'i nënshtrohet pagimit të detyrimeve tatimore, sipas ligjit nr. 8438/1998, "Për tatimin mbi të ardhurat" (të ndryshuar). Si rezultat, Komisioneri Publik e çmon të nevojshme një interpretim/orientim nga Kolegji lidhur me ligjshmërinë e shumës 20.000 euro.

17. Lidhur me kursimet familjare në shumën 9.000 euro

17.1 Për këtë burim të deklaruar, Komisioni, bazuar në informacionin e dërguar nga DRT Tiranë, me shkresën nr. *** prot., datë ***.2.2018, nga ku rezulton se bashkëshortja e subjektit ka realizuar fitim neto 655.000 lekë në vitin 2004 dhe 1.165.957 lekë në vitin 2005, arsyeton se:²³ "...shuma totale prej 1.820.957 lekë është një burim i mjaftueshëm për të justifikuar të ardhura të ligjshme në shumën prej 9.000 euro, përdorur për shlyerjen e këstit të dytë të apartamentit²⁴".

17.2 Nga aktet në dosje rezulton se: (i) Komisioni lidhur me ligjshmërinë e shumës prej 9.000 euro ka analizuar të gjitha të ardhurat e bashkëshortes së subjektit, që ka realizuar nga aktiviteti privat si person fizik gjatë vitit 2004. Ndërkohë, theksojmë se këto të ardhura janë përfshirë njëherë më parë në analizën financiare të Komisionit, kur është vlerësuar ligjshmëria e burimit të krijimit të pasurisë: Shtëpi banimi me sip. 268.2 m² dhe truall me sip. 330 m², ndodhur në Linzë, Tiranë; (ii) Vetë subjekti i rivlerësimit në përgjigjet e tij, të datës 19.10.2018, shprehet se: "... të gjitha mjetet monetare të realizuara prej bashkëshortes, deri në momentin kur mori hua shumën 23.000 euro (maj 2004), ishin vënë në dispozicion të ndërtimit të shtëpisë private".

17.3 Komisioneri Publik, për sa më sipër analizuar, çmon si të nevojshme kryerjen e një vlerësimi të plotë të situatës financiare nga ana e Kolegjit, mbi të ardhurat, shpenzimet dhe

²¹ Subjekti, në përgjigjet e datës 14.8.2018, ka referuar kontratën e kaparit nr. *** rep., nr. *** kol., datë ***.5.2008, e nënshkruar nga ***, në cilësinë e kaparpaguesit, dhe ***, dhe ***, në cilësinë e kaparmarrësve. Objekti i kësaj kontrate është dhënia e një shumë në formë kapari, prej 20.000 euro.

²² Referohuni pikës 4/1, germa "a", e rekomandimit.

²³ Referohuni f. 23-24, të vendimit të Komisionit.

²⁴ Sipas mandatit nr. ***, datë ***.1.2006, lëshuar nga shoqëria "****" sh.p.k., shuma e paguar është 12.000 euro. Sipas shpjegimeve të subjektit nga kjo shumë, 3.000 euro janë mbuluar me pjesën e mbetur të kredisë prej 23.000 euro dhe pjesa tjetër, prej 9.000 euro, është mbuluar me kursime familjare.

investimet²⁵ e kryera nga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, me qëllim rivlerësimin dhe kontrollin e ligjshmërisë të burimit të krijimit të shumës 9.000 euro.

18. Lidhur me pagimin e detyrimeve tatimore për fitimin e realizuar nga shitja e apartamentit me sip.102 m²

18.1 Nga aktet në dosje rezulton se personi i lidhur, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, znj. ***, ***, me anë të kontratës së shitjes me rezervë nr. *** rep., nr. *** kol., datë ***.4.2007, ka shitur apartamentin me sipërfaqe 102 m², ndodhur në adresën: rruga e “****”, Tiranë, kundrejt vlerës 50.000 euro.

18.2 Për të provuar shlyerjen e detyrimeve tatimore lidhur me fitimin e realizuar prej 18.000 eurosh nga shitja e kësaj pasurie²⁶, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur dokumentacionin bashkëlidhur shkresës së DRT Tiranë nr.*** prot., datë ***.8.2018, nga ku rezulton se: *detyrimet tatimore, në vlerën 378.000 lekë, janë paguar në datën *** janar 2017*”.

18.3 Komisioni²⁷, ndër të tjera, lidhur me pagesën e tatimit me vonesë, ka konkluduar se: *“...bazuar në pikën 19, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016, ...pagesa e këtij tatimi, përpara dorëzimit të Deklaratës “Vetting”, përmbush kriterin ligjor të burimit të ligjshëm....., pasi për shumën në fjalë është shlyer detyrimi tatimor”*.

18.4 Komisioneri Publik, duke u bazuar në praktikën e vendosur nga ana e Kolegjit²⁸ (dalë pas depozitimit të këtij ankimi), në konsideratë të faktit se pagesa e tatimit mbi të ardhurat është kryer rreth 10 vite më vonë, vetëm disa ditë para dorëzimit të D-Vett., që duket se është bërë për qëllim të procesit të rivlerësimit, në zbatim dhe të rekomandimit të ONM-së²⁹, vlerëson se fitimi i realizuar nga personi i lidhur në këtë rast, në shumën 18.000 euro, të cilat më pas kanë shërbyer si burim krijimi pasurie në pronësi të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur me të, duket se nuk plotëson kriteret e parashikuara nga neni D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës, si dhe nga neni 30, i ligjit nr. 84/2016, për t’u konsideruar si të ardhura të krijuara nga një burim i ligjshëm dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore sipas legjislacionit përkatës në fuqi, në kohën e krijimit.

19. Për pasurinë: Apartament duplex, me sipërfaqe totale 205.33 m² me nr. pasurie *, z. k. ***, fshati “****”, Durrës dhe pasuri truall me sip. 521, 8 m² me nr. pasurie ***, z. k. ***, fshati “****”, Durrës**

19.1 Në D-Vett., subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: (i) Apartament me sipërfaqe totale 205.33 m², fituar me kontratë sipërmarrje nr. *** rep., nr.*** kol., datë ***.6.2012, dhe kontratë shitblerje nr. *** rep., nr.*** kol., datë ***.8.2015. *Vlera: 82.132 euro. Pjesa takuese: 50% në bashkëpronësi me bashkëshorten; (ii) Truall me sip. 521.8 m², mbi të cilin ndodhet apartamenti. Pagesa për procesin e legalizimit në shumën 984.199 lekë, blerë në datën ***.9.2013.*

²⁵ Nga aktet në dosje na rezulton se bashkëshortja e subjektit, në datën ***.10.2005, me faturën tatimore nr. ***, ka blerë një automjet nga “****.***.***”, për shumën 1.200.000 lekë. Gjithashtu, nga dhjetori i vitit 2004 e në vazhdim, bashkëshortja e subjektit ka pasur shpenzime kredie, me kësht rreth 233 euro/muaj.

²⁶ Rezulton se apartamenti është blerë për vlerën 32.000 euro dhe është shitur në vlerën 50.000 euro.

²⁷ Referohuni arsytimit të Komisionit në f. 27, të vendimit.

²⁸ Për më tepër referohuni në vendimin (JR) nr. 23/2020, prg. 24.17.

²⁹ Referohuni paragrafit 4/1, germa “c” të rekomandimit të ONM-së.

Burimi krijimit: (i) 35.000 euro nga shitja e apartamentit, me sip. 48,27 m², në Shëngjin, Lezhë³⁰; (ii) 30.000 euro, kursime të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, krijuar para martese³¹.

19.2 Në deklaratat periodike të deklarimit të pasurisë për vitet 2012-2014, subjekti ka deklaruar shtesën e pasurisë; Apartament me sip. 205,33 m², si dhe pagesat e kryera në secilin vit.³²

19.3 Komisioni³³, për sa më sipër, ka arritur në përfundimin se: “...për pasurinë apartament banimi (dupleks) dhe truall i ndodhur në Kompleksin Rezidencial “***”, Durrës, deklaruar në deklaratën “Vetting”, trupi gjykues, sa më sipër arsyetuar, çmon se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të saktë, në kuptim të nenit 30 dhe nenit 33, pika 5 “a”, të ligjit nr. 84/2016, ka justifikuar dhe shpjeguar bindshëm krijimin e kësaj pasurie, në kuptim të nenit D të aneksit të Kushtetutës”.

20. Komisioneri Publik, në zbatim të rekomandimit të ONM-së³⁴, çmon të nevojshme riçeljen e hetimit dhe vlerësimin nga ana e Kolegjit të çështjeve si vijon:

20.1 Lidhur me burimin e deklaruar të ardhura nga shitja e apartamentit, me sip. 48.27 m², në Shëngjin, Lezhë, në shumën 35.000 euro

20.1.1 Nga aktet në dosje rezulton se apartamenti me sip. 48.27 m² është blerë në shumën 2.000.000 lekë, sipas kontratës së shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë ***.1.2010. Si burim për blerjen e kësaj pasurie ka shërbyer shuma 2.900.000 lekë, e përfituar nga subjekti i rivlerësimit, nga ekzekutimi i vendimit nr. ***, datë ***.6.2006, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për pjesëtimin e pasurisë bashkëshortore. Pasuria bashkëshortore e pjesëtuar rezulton të jetë apartamenti me sip. 73 m², i ndodhur në rrugën “****.***”, Tiranë, i blerë në datën ***.12.2003, për shumën 2.000.000 lekë.

20.1.2 Për sa më sipër, rezulton se shuma 35.000 euro, deklaruar si burim krijimi i pasurisë: Apartament *duplex*, me sipërfaqe totale 205,33 m² dhe truall me sip. 521,8 m², në Kompleksin Rezidencial “****”, Durrës, ka si origjinë të ardhurat nga shitja e apartamentit me sipërfaqe 73 m² në rrugën “****.***”, Tiranë.

20.1.3 Burimi i deklaruar nga subjekti i rivlerësimit për blerjen e pasurisë: Apartament me sip. 73 m² ndodhur në rrugën “****.***”, janë kursimet familjare me pjesë takuese 50% në bashkëpronësi me ish-bashkëshorten, znj. ***.***.

³⁰ Ky apartament është 100% në pronësi të subjektit. Blerë në shumën 2 milionë lekë, përfituar nga ekzekutimi i vendimit të pjesëtimit të pasurisë, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nr. ***, datë ***.6.2006.

³¹ Të ardhura të marra nga prindërit pas ndarjes nga trugu familjar, në vitin 2010, siguruar nga shitja në shumën 220.000 euro, e shtëpisë private 2 kate + papafingo 268.2 m² + truall me sip. 330 m². Lidhur me burimin e ligjshëm të diferencës së çmimit në vlerën prej 17.132 euro, subjekti, në përgjigjet e datës 14.8.2018, ka deklaruar si burim: (i) 5.000 euro të ardhura nga kursimet familjare të vitit 2012; (ii) 8.010 euro të ardhurat nga kontrata qiraje për vitin 2014; (iii) të ardhura familjare të vitit 2014, në shumën 4.122 euro.

³² Në DV-2012, subjekti ka deklaruar: Shtuar apartament me sip. 205.33 m² (158 m² sipërfaqe e brendshme dhe 47 m² sipërfaqe ballkoni), Komuna Ishëm, Durrës, fituar me kontratë nr. *** rep., nr. *** kol., datë ***.6.2012, për vlerën 82.132 euro. Subjekti deklaroi: likuidim i pjesshëm në shumën 40.000 euro, duke pakësuar gjendje *cash*.

Në DV-2014, në rubrikën: “Detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë”, subjekti deklaroi: shlyer totalisht detyrimi ndaj shoq. “****” për blerjen e ap. 205,35 m².

³³ Referohuni f. 48, të vendimit të Komisionit.

³⁴ Referohuni pikës 4/1, të rekomandimit.

- 20.1.4 Në analizë të ligjshmërisë së burimit të krijimit të kësaj pasurie, konstatojmë se, megjithëse Komisionit i ka rezultuar se ish-bashkëshortët Selita nuk mbulojnë me burime të ligjshme blerjen e pasurisë së apartamentit me sipërfaqe 73 m² në rrugën “***.***”, Tiranë, për një diferencë negative prej -225.245 lekë, në përfundim, ndër të tjera, ka arsyetuar se³⁵: “...kjo mangësi...nuk është e mjaftueshme në vetvete që të passjellë aplikimin e pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016”.
- 20.1.5 Ndërsa lidhur me verifikimin e burimit të ligjshëm të të ardhurave të ligjshme, të shumës 2.900.000 lekë, paguar subjektit të rivlerësimit nga ish-bashkëshortja, si rrjedhojë e ekzekutimit të vendimit për pjesëtimin e pasurisë bashkëshortore, Komisioni, ndër të tjera, ka arsyetuar se³⁶: “...nuk ka rrethana për të cilat ish-bashkëshortja e subjektit mund të bëhet person tjetër i lidhur... dhe, për sa kohë subjekti nuk ka qenë në një marrëdhënie huamarrje apo përfitimi të ndonjë dhurimi nga një person i tretë, ai nuk mbart detyrimin që të provojë burimin e ligjshëm të shumave të marra nga të tretët...”.
- 20.1.6 Në vlerësimin e Komisionerit Publik, marrë për bazë dhe rekomandimin e ONM-së³⁷, mangësitë e hetimit nga ana e Komisionit, për sa i takon të ardhurave që subjekti i rivlerësimit pretendon se janë krijuar duke pasur burim të ligjshëm pjesëtimin e sendit të paluajtshëm si pasojë e zgjidhjes së martesës, lidhen si me interpretimin ligjor të detyrimit të subjektit të rivlerësimit në rastin konkret specifik (pasuri bashkëshortore në pjesë ideale), ashtu dhe me administrimin e rrethanave të faktit (mundësisë financiare).
- 20.1.7 Është e vërtetë se subjekti i rivlerësimit, në momentin e përfitimit të shumës prej 2.900.000 lekë, ka zgjidhur martesën me ish-bashkëshorten e tij, por në vlerësimin e Komisionerit Publik, kjo pasuri (likuiditet) e ka origjinën nga një pasuri në bashkëpronësi bashkëshortore ligjore, në pjesë ideale, ligjshmëria e së cilës për t’u provuar mbetet detyrim i subjektit të rivlerësimit. I njëjti interpretim ligjor vlen dhe për hetimin e burimit të krijimit të të ardhurave në vlerën prej 2.000.000 lekë, në vitin 2003, që shërbyen për blerjen e apartamentit në rrugën “***.***”, Është vetë subjekti, që në deklarimin e tij të parë në vitin 2004, si burim për krijimin e pasurisë, ka deklaruar kursimet familjare, pra të tij dhe bashkëshortes së tij, në një regjim bashkëpronësie ligjore, në pjesë ideale. Në rrethanat kur mund të rezultojnë eventualisht nga kryerja e analizës financiare, një pamundësi e ish-bashkëshortëve Selita për të krijuar të ardhura të ligjshme në vitin 2003, për blerjen e këtij apartamenti, nuk mund të hamendësohet se kjo pamundësi i takon ish-bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, pa u hetuar ose administruar prova, që provojnë të kundërtën e detyrimit të justifikimit të burimeve të ligjshme për vënien e pasurisë.

20.2 Lidhur me burimin e deklaruar kursime të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, në shumën 30.000 euro, krijuar para martesë

- 20.2.1 Bazuar në deklarimet e subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur me të, bashkëshortes znj. ***.***, rezulton se shuma prej 30.000 euro, që ka shërbyer për blerjen e pasurisë:

³⁵ Referohuni arsyetimit të Komisionit në prg. 3.2.21, f. 36 e vendimit.

³⁶ Referohuni arsyetimit të Komisionit f. 37 e vendimit.

³⁷ Referohuni paragrafit 4/1, germa “b”, të rekomandimit të ONM-së.

Apartament *duplex*, me sipërfaqe totale 205,33 m² dhe truall me sip. 521,8 m², në Kompleksin Rezidencial “****”, Durrës, ka si origjinë të ardhurat e realizuara nga shitja e pasurisë shtëpi banimi me sip. 268,2 m² dhe truall me sip. 330 m², ndodhur në Linzë, Tiranë, në pronësi të familjes ***.

20.2.2 Nisur nga deklaratimet e subjektit të rivlerësimit dhe ato të personit të lidhur me të, bashkëshortes, në deklaratat vjetore të interesave private, rezulton se nga shitja e pasurisë: Shtëpi private me 2 kate + papafingo 268.2 m², për shumën 220.000 euro, bashkëshortja e subjektit deklaron se ka përfituar shumat si vijon: (i) 20.000 euro që kanë shërbyer për shlyerjen e kredisë pranë *** Bank; (ii) 61.758 euro që kanë shërbyer për të blerë apartamentin me sipërfaqe 94.6 m², në adresën rruga “****.***”, pallatet “****”, Tiranë dhe (iii) 30.000 euro, dhënë *cash* pas ndarjes nga familja. Sa më sipër rezulton se në total nga shitja e kësaj pasurie, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka përfituar shumën prej 111.758 euro, vlerë që i korrespondon rreth 55% të të ardhurave të përfituara nga shitja e shtëpisë private me sip. 268.2 m², ndërkohë që vetë subjekti dhe bashkëshortja e tij kanë deklaruar si pjesë takuese vetëm 25%³⁸.

20.2.3 Lidhur me ligjshmërinë e shumës 30.000 euro, Komisioni, ndër të tjera, ka arsyetuar³⁹: *“...se kjo shumë nuk përbën një të ardhur të tatueshme sipas germës “g”, të nenit 8, të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin për të ardhurat” (i ndryshuar) dhe pikës 2.3.9, të kapitullit 2.3, “Të ardhura të tatueshme”, të udhëzimit nr. 5, datë 30.1.2006, “Për tatimin për të ardhurat” (i ndryshuar), pasi shuma kryesore prej 220.000 euro, nga ku është shkëputur shuma 30.000 euro, është tatuar një herë dhe tatimi për herë të dytë, tërësisht apo pjesërisht, do të konsiderohej si problem me natyrë të theksuar diskriminimi nga zbatimi i ligjit në mënyrë të pabarabartë. Nën këtë arsyetim, trupi gjykues gjen edhe mendimin e dhënë nga dy institucionet: Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Drejtoria e Përgjithshme të Tatimeve, të cilat kanë dhënë qëndrimin e tyre se një e ardhur e tatuar në burim nuk i nënshtrohet tatimit për herë të dytë.”*

20.2.4 Komisioneri Publik, në zbatim të rekomandimit të ONM-së⁴⁰, për shumën 30.000 euro, deklaruar si e përfituar nga shitja e pasurisë në pronësi të prindërve të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, përveç sa më sipër trajtuar, lidhur me mundësinë financiare të familjes *** për krijimin e kësaj pasurie, vlerëson se mbetet e paqartë nëse kjo shumë do të kualifikohet si dhurim dhe nëse kualifikohet si e tillë, eventualisht t’i nënshtrohet pagimit të detyrimeve tatimore, sipas ligjit nr. 8438/1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar. Si rezultat, Komisioneri Publik çmon të nevojshme një interpretim/orientim nga Kolegji lidhur me ligjshmërinë e shumës 30.000 euro.

³⁸ Nga shkresat e përcjella nga ZQRPP, konstatohet se *de jure* pronar i vetëm i pasurisë shtëpi private me sipërfaqe 268.2 m² është babai i bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, z. ***.***, ndërsa në deklaratat e interesave periodike private, deklarohet pjesa takuese e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit 25%.

³⁹ Referohuni arsyetimit të Komisionit, f. 41 e vendimit.

⁴⁰ Referohuni pikës 4/1, germa “a”, të rekomandimit.

21. Për pasurinë autoveturë, marka “Daimler Chrysler”

21.1 Në *D-Vett.*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: Autoveturë, marka “Daimler Chrysler”, tipi (D) 211, blerë me kontratën nr. *** rep., nr. *** kol., datë ***.12.2009. *Vlera: 11.000 euro. Burim i krijimit:* (i) 900.000 lekë, “të ardhura nga vendimi i pjesëtimit nr. *** datë ***.6.2006, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; (ii) 4.000 euro dhuratë nga vëllai, ***.***, emigrant në Itali, prej vitit 2004 e në vazhdim; (iii) 66.000 lekë kursime⁴¹. *Pjesa takuese: 100%*.

21.2 Në *DV-2009*, deklarohet si burim i krijimit: (i) 4.000 euro dhuratë nga vëllai ***.*** dhe (ii) 7.000 euro (966.000 lekë) pakësim i gjendjes *cash*.

21.3 Komisioni, për pasurinë si më sipër, ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të saktë, në kuptim të nenit 30 dhe nenit 33, pika 5 “a”, të ligjit nr. 84/2016, ka justifikuar dhe shpjeguar bindshëm krijimin e kësaj pasurie, në kuptim të nenit D të aneksit të Kushtetutës.

21.4 Komisioneri Publik, lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie, konstaton se subjekti ka deklaruar shumën 900.000 lekë, si “të ardhura nga vendimi i pjesëtimit të pasurisë bashkëshortore”, për të cilat kemi mbajtur qëndrim më sipër në pikën 19.1.6 - 19.1.7.

21.5 Ndërsa lidhur me burimin e deklaruar: *4.000 euro dhuratë nga vëllai, ***.****, nga aktet e administruara në dosje, rezulton se për të justifikuar burimin e ligjshëm të të ardhurave të dhuruesit, në referencë të nenit 32/4, të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur dokumentacion nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore Itali. Bazuar në këtë dokumentacion, konstatohet se të ardhurat e realizuara nga z. ***.***, në vitin 2009⁴², janë në total në shumën 4.204,2 euro.

21.6 Komisioneri Publik, në analizë të dokumentacionit të administruar, si dhe bazuar në praktikën e deritanishme të Kolegjit për raste analoge, në analizimin e mundësisë financiare të personave të tjetër të lidhur, vlerëson se të ardhurat e realizuara nga z. ***.***, në vitin 2009, janë të pamjaftueshme për të justifikuar me burime të ligjshme, shumën e dhuruar subjektit të rivlerësimit.

III. A. 2 Për vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale

22. Komisionit, nga hetimi administrativ për vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale, bazuar në përcaktimet e nenit E të aneksit kushtetues, kreut VI të ligjit nr. 84/2016 dhe, për aq sa gjen zbatim, ligji nr. 96/2016, i kanë rezultuar disa gjetje dhe mangësi, nga ku ka konstatuar se: (i) subjekti i rivlerësimit, gjatë ushtrimit të funksionit, mund të ketë vepruar në kushtet e konfliktit të interesit apo të atij në dukje.

23. Komisioni ka administruar edhe një “Opinion”⁴³, nga vëzhguesi ndërkombëtar i çështjes, bazuar në nenin B, pika 3, shkronja “b” e aneksit të Kushtetutës. Sipas këtij “Opinion”, i cili në kuptim të nenit 49, pika 11 e ligjit nr. 84/2016, konsiderohet edhe si një përfundim i dhënë për rrethanën, çështjen konkrete, trajtohet fakti se: (i) subjekti i rivlerësimit duket se nuk është mjaftueshëm i ndjeshëm mbi mundësinë e konfliktit të interesit në dukje, për shkak të mundësisë

⁴¹ Bazuar në deklaramet e subjektit në përgjigje të rezultateve të hetimit, dërguar me *email*-in e datës 16.4.2019, f. 20.

⁴² Vit në të cilin i ka dhuruar subjektit shumën 4.000 euro.

⁴³ “Opinion” i Vëzhguesit Ndërkombëtar të OMN-së, i datës 31 maj 2019.

të ndërhyrjeve midis detyrës dhe funksionit të tij me atë të bashkëshortes së tij, si dhe (ii) në shumë çështje duket sikur subjekti nuk ka vepruar në një mënyrë të duhur me konfliktin e interesit në dukje, duke arritur kështu në konkluzionin se duhen marrë në konsideratë, në vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale të subjektit, dhe siç mund të jetë rasti, vlerësimi nëse neni 61/5 i ligjit nr. 84/2016 gjen zbatim.

24. Në analizë të rasteve si më sipër, ato ndahen në dy grupe, (i) çështjet në të cilat subjekti i rivlerësimit ka ushtruar funksionin në kushtet e konfliktit të interesit dhe (ii) grupi i çështjeve në të cilat subjekti i rivlerësimit ka vepruar në kushtet e konfliktit të interesit në dukje.

25. Për sa i përket grupit të parë, çështjet në të cilat subjekti i rivlerësimit ka ushtruar funksionin në kushtet e konfliktit të interesit, janë rastet e identifikuara si çështja “****” sh.p.k dhe “****” sh.p.k., ku konstatohet se:

25.1 Nga hetimi administrativ i Komisionit ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e relatorit të trupit gjykues, me vendimin nr. ***, datë ***.3.2017, ka gjykuar çështjen me palë ankuese, paditësi shoqëria tregtare “****” sh.p.k, dhe palë e paditur Bashkia Kamëz, me objekt padie: “Konstatimi i pavlefshmërisë absolute të ... urdhër zhdëmtimi... për sa i përket detyrimit për ndalimin e shumës prej 1.825.471 lekë së titullit ekzekutiv ndaj paditësit ...”.

25.2 Në këtë rast, Gjykata Administrative e Apelit ka vendosur ndryshimin e vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, pranimin pjesërisht të padisë dhe konstatimin e pavlefshmërisë absolute të urdhrit, për sa i përket detyrimit për ndalimin e shumës prej 1.825.471 lekë. Ndërkohë, nga rezultatet e hetimit administrativ, për kriterin e pasurisë, rezulton se në vitin 2015, me kontratën noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë ***.10.2015, administratori i shoqërisë “****” sh.p.k., z. ***.*** ka blerë apartamentin në pronësi të personit të lidhur, bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, në shumën e 110.000 euro.

25.3 Lidhur me këtë rast, Komisioni ka kërkuar edhe një opinion ligjor nga ana e ILDKPKI-së, në përgjigje të së cilës, me shkresën nr. *** prot., datë ***.2.2019, ky institucion ka arritur në përfundimin se “...rezulton e provuar, që subjekti i rivlerësimit, z. K. Selita, në lidhje me gjykimin dhe vendimmarrjen e kësaj çështjeje, ka vepruar në kushtet e konfliktit të interesave dhe të papajtueshmërisë së funksionit publik”.

25.4 Komisioni, për sa më sipër, ka arritur në përfundimin se: “... në konsideratë të fakteve: i) se në kohën e gjykimit ka rezultuar përmbushja e të drejtave dhe e detyrimeve sipas kontratës noteriale...; ii) se kjo pasuri ishte rivlerësuar dhe po ashtu ishte shitur pas tre muajve nga pala blerëse me një çmim më të lartë; iii) se nga provat e paraqitura nga subjekti kontratat e ngjashme me çmime të përafërta tregojnë se nuk ka një çmim preferencial, iv) se në lidhje me vendimmarrjen kjo gjykatë e ka pranuar pjesërisht këtë padi; v) se provat e paraqitura nga subjekti, vendimet e Gjykatës së Lartë, si dhe Gjykata Administrative e Apelit me trupa gjyqësore të ndryshme në objekt padie të njëjtë, tregojnë se është mbajtur i njëjti qëndrim” ... në vlerësimin tërësor të kësaj

çështjeje, trupi gjykues çmon se faktet dhe rrethanat dëshmojnë garanci të paanshmërisë së subjektit⁴⁴”.

26. Komisioneri Publik, në zbatim të rekomandimit të ONM-së⁴⁵, vlerëson se përfundimi i arritur nga Komisioni nuk është në pajtueshmëri me situatën faktike të konstatuar, pasi edhe pas kalimit të barrës së provës, mbetet e paqartë nëse subjekti i rivlerësimit ka vepruar në kushtet e konfliktit të interesit. Duket se Komisioni i ka dhënë rëndësi vlerësimit të rrethanave jo të drejtpërdrejta, duke mos vlerësuar nëse subjekti i rivlerësimit ka vepruar në kushtet e konfliktit të interesit apo jo, në referencë edhe të nenit 33/5, germa “d” e ligjit nr. 84/2016. Në këtë drejtim, faktet e analizuara prej Komisionit, nuk përjashtojnë dijeninë e subjektit të një rrethane të tillë faktike, marrëdhënien kontraktuale me bazë interesi pasuror të personit të lidhur dhe detyrimin e tij për të marrë masa në kushtet e nenit 72-73 të K. Pr. Civile, me qëllim shmangien në çdo rast të arsyeve serioze mbi garantimin e paanshmërisë së tij në kryerjen e funksionit të gjyqtarit.

26.1 Në kuadrin e trajtimit të këtij shkaku, nga analizimi i akteve në dosje, rezulton po ashtu se subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e relatorit të çështjes, me vendimin nr. ***, datë ***.5.2014, të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, ka gjykuar çështjen me palë ankuese, paditësi, shoqëria “****” sh.p.k., kundër Komisionit të Prokurimit Publik dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Ujësjellës - Kanalizimeve dhe person i tretë, bashkimi i operatorëve ekonomikë, shoqëria “****” sh.p.k., shoqëria “****” sh.p.k., “****” sh.p.k. dhe shoqëria “***.***” sh.p.k.. Në këtë rast, gjykata ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, e cila ka qenë në favor të palës së tretë.

26.2 Më herët nga ky vendim rezulton se subjekti i rivlerësimit, në vitin 2010, me kontratën noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë ***.1.2010, ka blerë apartamentin në Shëngjin, Lezhë për çmimin 2.000.000 lekë, nga shoqëria “****” sh.p.k., me pronar të vetëm, shtetasin ***.***. Më tej, një vit pas dhënies së vendimit, në vitin 2015, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të, bashkëshortja ***.***, me anë të kontratës noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë ***.12.2015, kanë blerë nga shtetasi ***.*** dhe bashkëshortja e tij, apartamentin në rrugën “***.***”, Tiranë, për vlerën 177.370 euro. Ndërsa në vitin 2016, në të njëjtën adresë, nga ky shtetas kanë blerë një apartament tjetër dhe një garazh, për shumën totale 70.000 euro.

26.3 Komisioneri Publik, në zbatim të rekomandimit të ONM-së⁴⁶, konstaton se ky rast nuk është vlerësuar nga ana e Komisionit dhe subjektit të rivlerësimit nuk i është kaluar barra e provës, megjithëse ajo merr rëndësi dhe përbën bazë të mjaftueshme, si për vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale, lidhur me ekzistencën e konfliktit të interesit, ashtu dhe në vlerësimin e përgjithshëm të të tria kritereve. Në këto kushte është e nevojshme që ky rast të trajtohet nga juridiksioni rivlerësues dhe kontrollues i Kolegjit, duke vlerësuar, nëse për rastet si më sipër, subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e relatorit të çështjes, ka gjykuar dhe dhënë vendim nën praninë apo influencën e interesave private të tij apo personit të lidhur me të, si dhe vlerësimi i qëndrimit të tij

⁴⁴ Pika 2.27 e Vendimit.

⁴⁵ Referohuni në pikën 4/2, nënpika a.2 (iii), të rekomandimit.

⁴⁶ Referohuni në pikën 4/2, nënpika a.1 (ii), të rekomandimit.

si magjistrat/gjyqtar, në raport me detyrimin ligjor për të hequr dorë nga gjykimi, referuar kërkesave të Kodit të Procedurës Civile dhe jo vetëm.

27. Për sa i përket grupit të çështjeve në të cilat çmujmë se subjekti i rivlerësimit ka vepruar në kushtet e konfliktit të interesit në dukje, konstatojmë se nga hetimi administrativ ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka gjykuar çështje me palë procedurale, administratën qendrore e vendore të tatim-taksave, në të cilat personi i lidhur me të, bashkëshortja, ka ushtruar funksione në rolin drejtues apo funksione të tjera. Në gjykimin e këtyre çështjeve, duket se subjekti jo në të gjitha rastet ka ndërmarrë veprimet e nevojshme për shmangien e konfliktit të interesit në dukje apo i ka marrë me vonesë ato (*çështja me palë Federata Shqiptare e Judos, shoqëria “***.***” sh.p.k., shoqëria “***.***”, “*** Bank” etj.*⁴⁷), sikundër ka vepruar në raste të tjera, në zbatim të detyrimeve të K. Pr. Civile.

27.1 Në përgjigje të barrës së provës për konstatimet si më sipër, subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet e tij, ndër të tjera, argumenton mbi bazën e precedentit të mosmiratimit nga ana e Kryetarit të Gjykatës së Lartë, të një rasti dorëheqje të tij nga gjykimi i një çështje me palë kompaninë “***” dhe Drejtoria Rajonale Tatimore e Tatimpaguesve të Mëdhenj, në të cilën personi i lidhur, bashkëshortja, ka mbajtur detyrën e Drejtorit. Referuar kësaj kërkesë, konstatohet se, pasi referohet që: *“akti...bllokimi i llogarive bankare nuk është pjesë e dosjes”*, subjekti vlerëson paraqitjen e dorëheqjes për të shmangur çdo perceptim mbi paanshmërinë e gjykimin.

27.2 Për sa u trajtua më sipër, shumica e trupit gjykues e Komisionit, ndër të tjera, ka arritur në përfundimin se: *“...në asnjë rast nuk u provua se subjekti kishte gjykuar çështje që mund të lidheshin me detyrën që kishte ushtruar bashkëshortja... subjekti ka përmbushur kërkesat e nenit 72-73 të K. Pr. Civile... dhe se ... ka ofruar garanci të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim për paanshmëri në gjykim”*.

28. Komisioneri Publik, në zbatim të rekomandimit të ONM-së⁴⁸, vlerëson se rastet e mësipërme (të cilat gjejnë trajtim të zgjeruar edhe në opinionin e dytë të ONM-së, depozituar gjatë hetimit administrativ të Komisionit, me nr. 147/1 prot., datë 31 maj 2019), duhet të merren në konsideratë për të arritur një vlerësim të plotë të çështjes lidhur me konfliktin e interesit për subjektin e rivlerësimit. Duket se shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit nuk provojnë të kundërtën e rezultateve të hetimit. Motivi që justifikon paraqitjen e dorëheqjes në këto raste, *shmangien e çdo perceptimi mbi paanshmërinë e gjykimin*, duket se nuk është respektuar për të gjitha rastet e ngjashme, dhe në disa raste ka qenë i vonuar. Ky fakt konstatohet edhe në ato çështje kur subjekti rezulton në cilësinë e relatorit të trupit gjykues dhe merr dijëni më herët nga anëtarët e tjerë, mbi konfliktin gjyqësor dhe përmbajtjen e dosjes (si p.sh.: në çështjen me subjektin “***.***.***” sh.p.k, “***”, “***.***...” sh.a., “*** Bank” sh.a. etj.⁴⁹).

28.1 Duke përfunduar për sa më sipër, Komisioneri Publik, nga një vlerësim tërësor i çështjes, konstaton se rastet e mësipërme nuk janë të shkëputura në raport me qëndrimin e subjektit për të shmangur situata të konfliktit të interesit faktik apo të atij në dukje. Këto gjetje, nëse konstatohen

⁴⁷ Për më tepër, referohuni në aneksin nr. 1, të rezultateve të hetimit.

⁴⁸ Referohuni në pikën 4/2, nënpika b), të rekomandimit.

⁴⁹ Për më tepër referohuni në aneksin nr. 1, të rezultateve të hetimit dhe rezultatet shtesë të hetimit.

të tilla edhe nga ana e Kolegjit, parë në një vlerësim tërësor, në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, mund të vlerësohet se çojnë në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut dhe ndodhet në kushtet e pamundësisë për plotësimin e mangësive nëpërmjet programit të trajtimit, referuar nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

Denocimet nga publiku

29. Komisioni është ndalur dhe në hetimin e denoncimeve të publikut (17), në të cilat, ndër të tjera, pretendohen mangësi të subjektit për kriterin e aftësive profesionale, lidhur me aftësinë për të gjykuar dhe atë organizative, si vonesa në gjykim, mosnjohim në kohë të palëve etj.

30. Nga analiza e këtyre denoncimeve, konstatojmë se jo të gjitha kanë gjetur trajtim të plotë nga ana e Komisionit apo edhe kur janë trajtuar, sërish përgjigjet e subjektit nuk janë shteruese për gjithë çështjet e ngritura. Nga vlerësimi i përmbajtjes së denoncimeve, pretendohen fakte dhe rrethana të cilat mund të marrin rëndësi në zbatim të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016 apo vlerësimit tërësor të çështjes.

31. *Lidhur me denocimet e paraqitura nga shtetasja ***.*** dhe ***.****

31.1 Komisioneri Publik, në zbatim të rekomandimit të ONM-së⁵⁰, konstaton se për rastin e denoncimit të paraqitur nga shtetasja ***.***, subjektit të rivlerësimit nuk i janë kërkuar shpjegime apo t'i jetë kaluar barra e provës nga ana e Komisionit, megjithëse nga përmbajtja e këtij denoncimi, ndër të tjera, duket se subjekti, në cilësinë e anëtarit të trupit gjykues, nuk përmbush kërkesat e dispozitave e K. Pr. C. dhe jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese mbi të drejtën e paditësit për të disponuar mbi objektin e padisë “...për ta ndryshuar, zgjeruar ose zvogëluar atë sipas interesave të tij/saj” (vendimi nr. 16/2013 i Gjykatës Kushtetuese). Ndërsa, për sa i përket rastit të denoncuar nga shtetasi ***.***, me gjithë shpjegimet e dhëna nga subjekti dhe arsyetimit të Komisionit, mbetet ende e paqartë, nëse subjekti, në cilësinë e relatorit të çështjes, vlerësoi të gjitha pretendimet e ngritura nga paditësi dhe nëse ai veproi në përputhje me jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese.

32. *Lidhur me denocimin e Kantierit të ndërtimit të anijeve (***.***.***) ****, Vlorë

32.1 Nga vlerësimi i këtij denoncimi, Komisionit i ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e relatorit të çështjes, në gjykimin e dy rasteve, me objekt gjykimi marrëdhëniet e punës sipas dispozitave të Kodit të Punës, i paditur Kantieri i ndërtimit të anijeve Vlorë, për fakte dhe rrethana të njëjta, subjekti ka mbajtur qëndrime të ndryshme, sa i takon analizës juridike dhe zgjidhjes së çështjes. Por, pas administrimit të shpjegimeve të subjektit, i ka gjetur bindëse ato për të kundërtën e barrës së provës.

32.2 Komisioneri Publik, në zbatim të rekomandimit të ONM-së⁵¹, duke u bazuar dhe në parashikimet e nenit E të aneksit të Kushtetutës, si dhe nenet 43 e 44 të ligjit nr. 84/2016, pa vlerësuar logjikën apo bazueshmërinë e vendimmarrjes në rastin konkret⁵², konstaton se edhe pas shpjegimeve

⁵⁰ Referohuni në pikën 4/2, nënpika a.1-a.2, të rekomandimit.

⁵¹ Referohuni në pikën 4/2, nënpika a.2 (i), të rekomandimit.

⁵² Referuar nenit 72/4, të ligjit nr. 96/2016, të ndryshuar.

të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, mbetet ende e paqartë, nëse subjekti, në cilësinë e relatorit të çështjes, ka përdorur argumentime të ndryshme në gjykimin e këtyre çështjeve, apo i është përmbajtur të njëjtit arsyetim ligjor, analizimit të jurisprudencës, argumentimit logjik dhe zgjidhjes së drejtë të rasteve të njëjta, parë kjo dhe në raport të kujdesit dhe cenimit ose jo të të drejtave të palëve procedurale. Në këtë drejtim, nga ana e Komisionit nuk rezulton të jetë vlerësuar fakti, se midis kërkimit të palës së paditur në ankim dhe vendimmarrjes së gjykatës, nga zgjidhja përfundimtare e gjykatës, kjo palë ka dalë në situatë më të disfavorshme në aspekt të detyrimit financiar.

32.3 Në kuptim të nenit 456 të K. Pr. Civile dhe nenit 49/2 të ligjit nr. 49/2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar, kjo vendimmarrje nuk është kërkuar nga pala paditëse, rrjedhimisht në zbatim të nenit 459 të këtij Kodi, çdo pretendim i kësaj pale mbi të drejtat që kishte fituar nga vendimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, do duhet të ishin konsideruar që ishte hequr dorë dhe kishin rënë në dekadencë. Objekt gjykimi në këtë rast ka qenë vetëm ankimi i palës së paditur, fakt i cili detyron gjykatën të shqyrtonte vetëm bazueshmërinë në ligj dhe në fakt të pretendimeve të ngritura në ankimin e palës së paditur, si mjeti juridik që i ka dhënë Gjykatës Administrative të Apelit juridiksionin rishikues, e njëkohësisht ka përcaktuar kufijtë e gjykimit. Në këtë drejtim, mbajmë në konsideratë edhe praktikën unifikuese të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, vendimin nr. 3/2009⁵³.

33. Lidhur me denoncimin e bërë nga disa gjyqtarë

33.1 Në zbatim të rekomandimit të ONM-së, mungesa e një hetimi shterues vërehet edhe në rastin e denoncimit nga një grup gjyqtarësh, nga ku rezulton se Komisioni nuk është shprehur për të gjitha elementet dhe çështjet e paraqitura në të. Në këtë denoncim, përveç të tjerash, ngrihen pretendime edhe mbi vendimmarrjen e subjektit të rivlerësimit në çështjen gjyqësore që i përket vendimit nr. *** (***), datë ***.2.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, me palë paditëse ***.***, kundër Presidentit të Republikës.

33.2 Për këtë rast, Komisioni ka konkluduar se ekzistojnë mangësi profesionale të subjektit të rivlerësimit dhe bazuar në pikën 4, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, ka vendosur të transferojë këtë çështje pranë organit kompetent për inspektimin e shkaqeve që mund të përbëjnë shkelje disiplinore, pasi ka vlerësuar: (i) ekzistencën e mospërputhjeve mes kërkimit të paditësit dhe disponimit përfundimtar të vendimit të gjykatës, pasi paditësi nuk ka kërkuar që t’i njihen të drejtat dhe të trajtohet në përputhje me ligjin material dhe procedural të ndryshuar, që e detyron Këshillin e Lartë të Prokurorisë (në vijim referuar KLP) të kryejë procedurat e posaçme të emërimit të një prokurori; (ii) rolin aktiv të gjykatës/subjektit, lidhur me saktësimin e pikës 3 të dispozitivit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, duke detyruar KLP-në të bëjë emërimin e paditësit si prokuror; (iii) tejkalimin e kompetencës në rregullimin e ndërgjyqësisë në këtë proces; dhe (iv)

⁵³[...] Fryma që karakterizon Kodin e Procedurës Civile është përcaktimi si rregull i një roli kryesisht pasiv për gjykatën (me përjashtime të mirëpërcaktuara, kryesisht sa i përket fazës së hetimit gjyqësor). Konform nenit 6 të K. Pr. Civile, gjykata kur gjykon mosmarrëveshjet e ndryshme duhet të shprehet mbi gjithçka që kërkohet dhe vetëm për atë që kërkohet... Parimi i përputhjes midis asaj që kërkohet dhe asaj për të cilën shprehet gjykata është parim bazë i së drejtës procedurale civile, pasi nuk mund të ketë ultra petita partium [...].

mosarsyetimin e rolit dhe kompetencave të palës ndërgjyqëse/KLP-së, në momentin e zëvendësimit të saj, sipas ligjit nr. 96/2016.

33.3 Në përgjigje të rezultateve të hetimit si më sipër, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, në shpjegimet e tij, argumenton se: “Saktësimi i pikës 3 të dispozitivit të vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë ka qenë i diktuar nga ndryshimet kushtetuese dhe ligjore që ndodhën, pas zhvillimit të gjykimit në shkallë të parë dhe para përfundimit të gjykimit në Gjykatën Administrative të Apelit, e që sollën si pasojë kalimin e kompetencës së emërimit të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë nga Presidenti i Republikës të Këshilli i Lartë i Prokurorisë (neni 159/2, germa “c” e ligjit nr. 115/2016)”. Sipas subjektit, saktësimi i dispozitivit nuk është parë lidhur me saktësimet e tjera që vijnë nga ligji nr. 96/2016.

33.4 Duket se referenca ligjore që subjekti i rivlerësimit bën në këtë rast, neni 159/2, germa “c” e ligjit nr. 115/2016, është i gabuar, pasi kjo dispozitë është shfuqizuar nga Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 41/2017, ndërkohë që vendimi nga Gjykata Administrative e Apelit është marrë në shkurt të vitit 2019. Kjo referencë ligjore, suksedimi procedural nga Institucioni i Presidentit të Republikës të KLP, bazuar në nenin 199/2 të K. Pr. Civile, si dhe parimi i vazhdimësisë institucionale e ligjore janë elemente ku bazohet argumentimi i subjektit.

33.5 Argumentimi i përdorur nga subjekti i rivlerësimit për këtë rast duket se nuk sqaron faktin se, megjithëse objekti i gjykimit ka vijuar i njëjtë nga shkalla e parë edhe në Gjykatën Administrative të Apelit, pra në aspektin material e atë procedural, kufijtë e shqyrtimit të çështjes objekt gjykimi nuk kanë ndryshuar, përtej kërkimeve të nenit 465 të K. Pr. Civile, legjitimiteti pasiv i ankuesit/palës së paditur është kaluar te KLP-ja.

33.6 Duke përfunduar për sa më sipër, Komisioneri Publik, në zbatim të rekomandimit të ONM-së⁵⁴, vlerëson se, në marrjen e vendimit për transferimin e çështjes tek organi kompetent për inspektim, Komisioni nuk ka arsyetuar nëse mangësitë e konstatuara brenda kuadrit të vlerësimit të kriterit profesional shërbejnë dhe marrin rëndësi për vlerësimin në tërësi të çështjes për qëllim të procesit të rivlerësimit.

IV. Kërkimi i ankimit

34. Në përfundim të këtyre parashtrimeve, Komisioneri Publik çmon se është e nevojshme që nga ana e këtij trupi gjykues të çelet hetimi gjyqësor, me qëllim hetimin e shkaqeve të këtij ankimi dhe administrimi eventual i provave të reja.

KOMISIONERI PUBLIK

Florian BALLHYSA

⁵⁴ Referohuni në pikën 4/2, nënpika a.2 (iv).